




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office



NEW



HTTP



## RAPORTI I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit

Prishtinë, prill 2024

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji<sup>1</sup> i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000<sup>2</sup>) dhe Udhëzuesin për Auditimin e Sistemeve të Informacionit (GUID 5100<sup>3</sup>).

Auditimet e teknologjisë së informacionit të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të fituar siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit<sup>4</sup>, ekonomisë<sup>5</sup>, dhe efektivitetit<sup>6</sup> të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrolleve përkatëse.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit “Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit” në konsultim me Ndhimës Auditoren e Përgjithshme Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Samir Zymberi, Drejtor i departamentit të auditimit;  
Poliksena Berisha, Udhëheqëse e ekipit; dhe  
Gazmend Lushtaku, Anëtar i ekipit

---

<sup>1</sup> Ligji 05\_L\_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

<sup>2</sup>SNISA 3000 – Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

<sup>3</sup> GUID 5100 – Udhëzuesi për auditimin e sistemeve të informacionit lëshuar nga INTOSAI

<sup>4</sup> Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës

<sup>5</sup> Ekonomia –Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë

<sup>6</sup> Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arrijten e objektivave të paracaktuara dhe arrijten e rezultateve të pritura.a

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	5
1 Hyrje .....	7
2 Objektivi dhe fushat e auditimit.....	9
3 Gjetjet e auditimit.....	10
3.1 Qeverisja e Teknologjisë së Informacionit dhe Operacionet e TI-së.....	11
3.2 Politikat e kontraktimit dhe Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm .....	13
4 Konkluzionet .....	18
5 Rekomandimet .....	19
Shtojca I. Dizajni i auditimit .....	20
Fushat me rrezik dhe motivi i auditimit.....	20
Përshkrimi i sistemit .....	21
Përgjegjësitë e institucioneve dhe dokumentet relevante .....	21
Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit.....	24
Pyetjet audituese .....	24
Kriteret e auditimit .....	25
Metodologjia e auditimit.....	26
Dokumentet relevante.....	28
Shtojca II: Letër Konfirmimi .....	29

---

## Lista e shkurtesave

AK	Autoriteti Kontraktues
CSS	Cascade Style Sheet (Vegël për stilizimin e ueb-aplikacioneve)
DIEKPÇL	Departamenti për Integritim Evropian, Koordinim të Politikave dhe Çështjeve Ligjore
EUROSAI	European Organization of Supreme Audit Institutions (Organizata Evropiane për Institucionet Supreme të Auditimit)
HTML	Hyper Text Markup Language (Gjuhë standardizuese për markimin e dokumenteve për shfaqje në ueb)
IDI	INTOSAI Development Initiative (Iniciativa e Zhvillimit e INTOSAI)
INTOSAI	International Organization of Supreme Audit Institutions (Organizata Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit)
IPA	Instrumenti i Para-Anëtarësimit
ISACA	Information Systems Audit and Control Association (Shoqata për Kontrollën dhe Auditimin e Sistemeve të Informacionit)
ISCED	International Standard Classification of Education (Standard Ndërkombëtar për Klasifikimin e Edukimit)
KE	Komisioni Evropian
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
OE	Operator Ekonomik
PHP	Hypertext Preprocessor (Gjuhë për zhvillimin e uebit)
SIMFK	Sistemi i Menaxhimit të Financave të Kosovës
SLA	Service-Level Agreement (Marrëveshja në nivel të shërbimit)
TI	Teknologjia e Informacionit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
WGITA	Working Group Information Technology and Auditing (Grupi Punues për Teknologji Informativ dhe Auditim)
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

## Përmbledhje e përgjithshme

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka rol dhe përgjegjësi të krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë arsimin parauniversitar, arsimin e lartë dhe shkencën në Kosovë. Kjo ministri harton politikat për mënyrën e mësimdhënies, mësim nxënies dhe përcaktimin e kriterëve për mënyrën e vlerësimit dhe notimit të nxënësve në nivel vendi. Gjithashtu, me rritjen e trendit të zhvillimit në fushën e teknologjisë së informacionit Qeveria ka investuar në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit edhe në arsim, duke investuar në projekte që kanë të bëjnë me digjitalizimin e arsimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit për të vlerësuar nëse Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka menaxhuar dhe zbatuar projektin e teknologjisë së informacionit "Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit" në mënyrë efektive për të përmbushur objektivat e këtij projekti dhe qëllimin e ministrisë për digjitalizimin e procesit mësimor dhe të testimit/vlerësimit të maturës.

Gjatë viteve 2013-2017, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka zhvilluar projektin për digjitalizimin e arsimit parauniversitar në Kosovë, në vlerë prej 4,931,000 euro. Për zhvillimin e këtij projekti Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka negociuar marrëveshjen për kredi të butë, përmes bankës austriake UniCredit Bank Austria dhe Qeverisë Austriake si garantues, e cila është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2014 dhe do të paguhet deri më 30 shtator 2032 në një vlerë totale 5,637,519 euro (përfshirë kryegjënë, interesin, tarifat). Me zhvillimin e këtij projekti do të krijohet sistemi me dy module, për komponentin e mësimit elektronik dhe komponentin e digjitalizimit të provimit të maturës, si dhe serverët për vendosjen e sistemit të zhvilluar.

Mirëpo, projekti në fjalë nuk është funksionalizuar dhe nuk janë arritur qëllimet e këtij projekti për e-edukimin dhe digjitalizimin e provimit të maturës.

*Ministria ka dështuar në projektin për digjitalizimin e arsimit para-universitar.* Ky projekt i financiar plotësisht nga huamarrja është realizuar pa planifikim paraprak i cili është përcjell me mangësi gjatë zhvillimit që kanë ndikuar në mos arritjen e qëllimit dhe përmbushjes së misionit të organizatës. Për më tepër, Ministria nuk ka siguruar pajisjet thelbësore dhe infrastrukturën harduerike dhe të rrjetit për qëllime të këtij projekti. Sistemi i zhvilluar nuk ka arritur të zbatohet në shkolla për shkak të mungesës së pajisjeve të nevojshme dhe qasjes në rrjet për përdoruesit. Rrjedhimisht, ky sistem është jo funksional, duke rezultuar në dëmtim të buxhetit të Kosovës prej rreth 5.6 milion euro, të cilat janë huamarrje dhe duhet të shlyhen deri në vitin 2032.

**Ministria nuk ka arritur** të ofrojë dokumentacionin e nevojshëm/mjaftueshëm dhe qasjen në sistemet e informacionit, të kërkuara gjatë auditimit. Kjo ka kufizuar dukshëm fushëveprimin e auditimit. Për më tepër, Ministria nuk ka arritur të sigurojë efikasitetin e produktit/sistemit të projektit, veçanërisht në lidhje me aftësinë e tij për t'i shërbyer qëllimit të tij zhvillimor, e aq më pak që sistemi ka mbetur i pashfrytëzuar dhe i pa mirëmbajtur për një periudhë të gjatë kohore. **Ministria nuk ka arritur të menaxhoj siç duhet me projektin duke dështuar të caktoj menaxher të projektit dhe personel përgjegjës.** Ministria ka kryer pagesën për punën e realizuar nga Operatori Ekonomik pa e bërë ende pranimin komisioni i pranimit, duke mos arritur të siguroj se

produkti i pranuar është në pajtim me kontratën. Rrjedhimisht, projekti mbetet i pa raportuar si i përfunduar, me pagesën përfundimtare të procesuar për shkak të mosveprimit (heshtjes) të Ministrisë. Kjo pagesë nuk është e regjistruar në SIMFK si shpenzim. **Gjithashtu, Ministria nuk ka arritur të sigurojë monitorimin e zbatimit të marrëveshjes**, prandaj nuk kishte raporte se ky sistem i zhvilluar është mirëmbajtur dy vite pas pranimit, siç është paraparë në marrëveshje. Për më tepër, parametrat e sigurisë që sigurojnë konfidencialitetin dhe mirëmbajtjen e qasjes të sistemit nuk janë zbatuar, duke rezultuar në humbjen e qasjes në sistem dhe pajisjet përkatëse.

Me qëllim të adresimit të çështjeve të identifikuara lidhur me menaxhimin dhe zbatimin e projektit të teknologjisë së informacionit “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”, si dhe, menaxhimin e projekteve të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përgjithësi, ne kemi dhënë 14 rekomandime për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

### **Përgjigjja e entitetit**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe është zotuar se do t’i zbatoj rekomandimet e dhëna.

# 1 Hyrje

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe departamentet e saj kanë rol kyç në hartimin dhe mbikëqyrjen e programeve mësimore dhe janë përgjegjëse për hartimin, administrimin dhe vlerësimin e të gjithë instrumenteve vlerësuese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Arsimi fillor ka rol primar në zhvillimin e përgjithshëm të një shoqërie dhe përveç ndikimit social është një mekanizëm i fuqishëm për zhvillimin ekonomik të vendit. Sipas raportit “Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022/23” Kosova ka 275,996 nxënës në arsimin fillor dhe të mesëm (të ulët dhe të lartë) nga 1.8 milionë banorë sipas regjistrimit të popullsisë të realizuar në vitin 2011. Prandaj, edhe MASHTI si bartëse e përgjegjësisë për këtë fushë ka zhvilluar projekte në avancimin dhe digjitalizimin e arsimit në Kosovë.

Arsimi në Kosovë është i organizuar sipas këtyre programeve dhe klasifikuar sipas Klasifikimit ISCED<sup>7</sup>-2011 që përdoret ndërkombëtarisht në statistikat e arsimit:

Tabela 1. Struktura Kombëtare e Arsimit dhe Fushat e Studimit në Kosovë<sup>8</sup>, me theks në strukturën e arsimit para universitar

ISCED 2011
0 Edukimi në fëmijërinë e hershme
01 Zhvillimi edukativ në fëmijërinë e hershme (fëmijët nën moshën 3 vjeçare)
02 Parafillor (fëmijët 3 vjeç e më shumë)
1 Arsimi Fillor
2 Arsimi i Mesëm i Ulët
3 Arsimi i Mesëm i Lartë
4 Arsimi Pas-sekondar jo terciar
5 Cikli i shkurtër terciar
6 Bachelor ose niveli ekuivalent
7 Master ose niveli ekuivalent
8 Doktoratura ose niveli ekuivalent

Me rritjen e rëndësisë së teknologjisë së informacionit e të komunikimit në jetën tonë të përditshme është rritur edhe roli dhe rëndësia e individit në procesin e të nxënës (mësimdhënies dhe mësim nxënies). Qeveria ka investuar në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit (TIK) dhe ka planifikuar të vë në zbatim mësimin elektronik (e-learning) si qasje plotësuese për mënyrën më konvencionale të të mësuarit në klasë. Kjo është një fushë e cila ka kërkuar investime të konsiderueshme për të aftësuar mësimdhënësit dhe menaxherët që të shtojnë dijet dhe të ndryshojnë qasjen tradicionale. Ndërsa, Qeveria është zotuar të sigurojë teknikë të kualifikuar dhe mjete të duhura financiare për sigurimin e pajisjeve, programeve softuerike, mirëmbajtjes dhe të përkrahjes teknike, për realizimin e synimit të digjitalizimit të shkollave, me qëllim të sigurimit të mundësisë së mësimin elektronik dhe realizimit të vlerësimit elektronik për testin e maturës për arsimin para universitar.

Qeverisa e Republikës së Austrisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, të përfaqësuara nga ministrat e financave kanë bërë marrëveshje për bashkëpunim financiar deri në shumën 20 milionë


<sup>7</sup> International Standard Classification of Education (Standard Ndërkombëtar për Klasifikimin e Edukimit)

<sup>8</sup> Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022/23

euro për realizimin e projekteve të përbashkëta mes tyre. Prandaj si rezultat, në vitin 2014, Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë ratifikimin e marrëveshjes për kreditë eksportuese ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG lidhur me financimin e projektit “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”, më tutje do ta përdorim “e-Edukimi”, me një vlerë totale të projektit prej 4,931,000 euro. Për realizimin e lidhjes së marrëveshjes së blerjes nr. KOS 2013-e.Edukimi, të vitit 2013, në mes të OE “Bit Media e-Learning Solution GmbH & Co KG” dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

Nga kjo marrëveshje OE-ja austriake kishte obligim të sigurote softuerin dhe serverët ku do të vendosej aplikacioni, për të cilin do të ofronte trajnimet, mirëmbajtjen dhe përkrahjen edhe për 24 muaj pas dorëzimit dhe pranimit të projektit.

Ndërsa, MASHTI do të sigurote infrastrukturën harduerike (pajisjet kompjuterike dhe qasjen në rrjet) në shkollat e Republikës së Kosovës ku edhe do të zbatohet projekti.



*Figura 1. Obligimet dhe detyrat e palëve në projekt*

Prej vitit 2014 deri në vitin 2023 për këtë projekt Qeveria e Kosovës ka paguar vlerën prej 740,945euro në emër të kryegjësë, interesit dhe tarifave sipas kontratës/marrëveshjes. Pjesa e mbetur për pagesë deri në përfundim, sipas planit të pagesave është 4,896,574euro. Gjithsejtë shuma që do të paguhet për këtë projekt deri në vitin 2032 është 5,637,519 euro.

Përderisa kredi dhënësi Unicredit Bank Austria AG në bazë të marrëveshjes/kontratës për realizimin e projektit ka paguar OE (“Bit Media e-Learning Solution GmbH & Co KG”) për vlerën e projektit prej 4,931,000euro.



## 2 Objektivi dhe fushat e auditimit

Objektiv i këtij auditimi është të vlerësohet nëse MASHTI ka menaxhuar dhe zbatuar projektin e teknologjisë së informacionit “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit” në mënyrë efektive për të përmbushur objektivat e këtij projekti dhe qëllimin e ministrisë për digjitalizimin e procesit mësimor dhe të testimit/vlerësimit të maturës.

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë rekomandime relevante për MASHTI-in, në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi dhe zbatimi i projekteve për sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Për t’iu përgjigjur objektivit të auditimit, jemi fokusuar në fushat e auditimit si në vijim:

Tabela 2: Fushat dhe çështjet e auditimit

Fushat e auditimit	Çështjet e auditimit
1. Qeverisja e TI-së dhe Operacionet e TI-së	1. Identifikimi, Drejtimi dhe Monitorimi i kërkesave të biznesit;
	2. Menaxhimi i vazhdimësisë së shërbimit të TI-së;
2. Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm, si dhe Politikat e kontraktimit	3. Menaxhimi dhe Kontrolli i projektit;
	4. Sigurimi dhe Testimi i Cilësisë;
	5. Monitorimi i furnizuesit ose kontraktorit;
	6. Marrëveshja në Nivel Shërbimi (SLA);
	7. Siguria.

Fushëveprimi i këtij auditimi është MASHTI dhe departamentet përkatëse për menaxhimin e TI-së dhe projektin “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”. Auditimi do të mbulojë periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2023.

### 3 Gjetjet e auditimit

Në këtë kapitull janë paraqitur gjetjet e auditimit që ndërlidhen me procesin e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të projektit “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”, i cili është zhvilluar nga palët përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e projektit në MASHTI. Projekti ka vlerë 4,931,000 euro, i cili përmes huamarrjes ka arritur vlerën totale 5,637,519 euro. Gjetjet janë të strukturuar sipas fushave dhe çështjeve të auditimit.




Figura 2. Struktura e çështjeve të auditimit në MASHTI

**Pjesa e parë** e paraqitur në kapitullin 3.1 mbulon çështjet e identifikuara e që kanë nevojë për përmirësim që lidhen me qeverisjen e TI-së dhe operacionet e TI-së (1-2).

**Pjesa e dytë** që është paraqitur në kapitullin 3.2 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me politikat e kontraktimit, zhvillimin, blerjen dhe kontraktimin e jashtëm (3-6).

### 3.1 Qeverisja e Teknologjisë së Informacionit dhe Operacionet e TI-së

Qeverisja e TI-së përkufizohet si strukturë e përgjithshme që udhëheq operacionet e TI-së të një institucioni dhe siguron që sistemet e TI-së mbështesin dhe mundësojnë arritjen e objektivave të institucionit, si dhe luan një rol kyç në përcaktimin e një mjedisi kontrollues dhe raportues. Elementet kyçe të qeverisjes së TI-së janë: planifikimi i TI-së; strukturat, standardet, politikat, procedurat dhe burimet njerëzore, etj.<sup>9</sup>



Figura 3. Qeverisja e TI-së dhe Operacionet e TI-së

#### 1. MASHTI në vitin 2013 pa ndonjë analizë dhe planifikim paraprak ka nënshkruar marrëveshjen për zhvillimin e projektit përmes procesit të huamarrjes

Organizatata duhet të menaxhojnë projektet dhe investimet e tyre të TI-së, me qëllim maksimizimi të përfitimeve dhe konsiderimin e elementëve, të tillë si rrezikun, kapacitetet, dhe prioritarizimi në mes investimeve konkurruese. Organizata duhet të analizoj, prioritarizoj dhe menaxhoj kërkesat për t'u siguruar se nevojat e përdoruesve janë plotësuar në mënyrë optimale dhe me kosto efektive.<sup>10</sup>

MASHTI nuk ka një dokument planifikimi paraprak për të zhvilluar një projekt të TI-së për digjitalizimin e sistemit të edukimit në arsimin parauniversitar të Kosovës, të cilin do të duhej ta kishte hartuar para nënshkrimit të marrëveshjes për zhvillimin e projektit në vitin 2013. Për më tepër, në takimet e realizuara gjatë këtij auditimi me zyrtarët përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe të TI-së të Ministrisë, nuk arritën të na siguronin se është bërë planifikim për këtë projekt gjatë periudhës kohore deri në vitin 2013. Dokumentet që na ofruan për analizat dhe nevojat e asaj kohe ishin më shumë të infrastrukturës dhe më esenciale për arsimin parauniversitar, se sa një sistem i digjitalizuar për arsimin parauniversitar. Sepse, ende kishte mungesë të objekteve, planifikimit të kurrikulave, infrastrukturës përcjellëse të shkollës, prandaj këto ishin nevoja me prioritet për investim, për realizimin e procesit mësimor.

Në "Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017" nuk është theksuar nevoja për zhvillimin e një projekti të tillë. Po ashtu as në "Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të vitit 2011" dhe atë të rishikuar më vonë në vitin 2016, si dhe në dokumentet dhe

<sup>9</sup> Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Qeverisja e TI-së.

<sup>10</sup> Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Qeverisjen e TI-së.

bazën e të dhënave për planifikimin e infrastrukturës për arsimin parauniversitar, nuk është paraqitur nevoja që gjatë asaj periudhe kohore të zhvillohej një sistem për digjitalizimin e arsimit parauniversitar.

Si arsye për zhvillimin e këtij projekti, në dokumentacionin e projektit gjejmë referencimin e Strategjisë së Arsimit. Ndërsa në Planin Strategjik për Arsim në Kosovë për vitet 2011-2016 hasim "Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit" si një kapitull që ka trajtuar edhe nevojat e zhvillimit të TI-së në shkolla dhe të nxënësve elektronik. Aty është vendosur në një paragraf zhvillimi i strategjisë së të nxënësve elektronik, dhe që zhvillimi i saj do të mbështetej nga Komisioni Evropian .

Për më tepër, nuk ka pasur as ndonjë grup punues për analizimin e gjendjes dhe nevojave për digjitalizim, si dhe krijimin e një plani ideor për zhvillimin e këtij projekti.

Në kohën para realizimit të këtij projekti (2013), nevojë kryesore për arsimin parauniversitar ishte sigurimi i infrastrukturës bazike për mësim, prandaj nuk kishte parakushte për planifikim dhe zhvillimin e një projekti të tillë si nevojë me prioritet. Prandaj ka mungesë të përfshirjes së zyrtarëve përgjegjës nga ana e MASHTI-t dhe mungesë të dokumenteve të planifikimit.

Si rrjedhojë është zhvilluar një projekt me vlerë 4,931,000 euro, pa ndonjë planifikim të duhur dhe më mangësi gjatë zhvillimit të projektit që kanë ndikuar në mos arritjen e qëllimit dhe përmbushjes së misionit të organizatës, për digjitalizimin e arsimit parauniversitar.

## **2. MASHTI nuk ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e projektit**

*Menaxhimi i kapaciteteve të TI-së duhet të bëhet sipas planifikimit dhe monitorimit të burimeve kompjuterike dhe të rrjetit për të siguruar që burimet e disponueshme të përdoren në mënyrë efikase dhe efektive. Plani i kapaciteteve duhet të zhvillohet bazuar në të dhëna nga përdoruesit dhe menaxhmenti i Sistemeve të Informacionit dhe ky plan duhet të rishikohet dhe përditësohet të paktën çdo vit.<sup>11</sup> Klienti (MASHTI) është përgjegjës të siguroj përgatitjet e nevojshme për instalim që i bartë sipas instruksioneve të Operatorit Ekonomik dhe kërkesave teknike. Klienti duhet të bëjë parapërgatitjet e nevojshme teknike në mënyrë që Operatori Ekonomik të instaloj softuerin.<sup>12</sup>*

Në kohën e zhvillimit të projektit nuk kishte infrastrukturë bazike për përdorimin e sistemit nëpër shkolla. Andaj, sistemi i zhvilluar nuk ka arritur të zbatohet në shkolla duke mos pasur pajisje dhe rrjet për t'u qasur përdoruesit. MASHTI nuk ka arritur t'i përmbushë obligimet e marrëveshjes për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme harduerike dhe të rrjetit për të mundësuar përdorimin e sistemit që do të zhvillohej nga ky projekt për digjitalizimin e sistemit të e-Edukimit. Nuk ka arritur të realizoj/siguroj përgatitjet e nevojshme teknike sipas marrëveshjes, që t'i mundësoj OE-së të instaloj softuerin. MASHTI gjatë kohës së zhvillimit të projektit, në fazat testuese ka përdorur infrastrukturën që ka ekzistuar në disa prej shkollave. Mirëpo, ajo infrastrukturë ka rezultuar të jetë e pamjaftueshme, prandaj nuk ka vazhduar të përdoret edhe pas zhvillimit të projektit.

Prandaj në mungesë të planifikimit adekuat, MASHTI nuk ka qenë i gatshëm të sigurojë këto kritere për projektin në fjalë.

<sup>11</sup> ISACA - Manuali i Rishikuar Edicioni i 27të, i përditësuar për praktikën e punës 2019, për Certifikimin e Auditorit të Sistemeve të Informacionit.

<sup>12</sup> Kontrata për Modernizimin e sistemit të edukimit të Kosovës përmes e-Edukimit, nr. Reference :KOS 2012 - e-Edukimi, Instruksione për ofertuesit.

Për shkak të mos përgatitjeve të nevojshme rreth sigurimit të infrastrukturës harduerike dhe të rrjetit, sistemi i zhvilluar nuk është zbatuar në shkolla, në mungesë të pajisjeve dhe rrjetit për t'u qasur përdoruesit.

### 3.2 Politikat e kontraktimit dhe Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm

Organizatave duhet të kenë disa politika të cilat përcaktojnë se cilat funksione mund të kontraktohen dhe cilat funksione duhet të zhvillohen në ambientet e organizatës. Kontraktimi i shërbimeve në organizatë kërkon monitorim të afërt dhe është subjekt i kërkesave të privatësisë dhe sigurisë.<sup>13</sup>

Zhvillimi, blerja dhe kontraktimi i jashtëm, sigurojnë se menaxhimi dhe kontrolli i projektit, testimi dhe siguri i cilësisë mbështesin në vazhdimësi zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve të TI-së në MASHTI.<sup>14</sup>



Figura 4. Politikat e kontraktimit, Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm

#### 3. Mungesa e qasjes në sistem dhe mungesa e dokumentacionit/informacionit të nevojshëm për auditim që ndikon në fushëveprimin e auditimit

Organizata duhet të ketë dispozitat/parametrat e përcaktuar në Marrëveshjen në Nivel Shërbimi (kontratë) dhe veprimet për përcjelljen e tyre nga organizata.<sup>15</sup> Klienti (MASHTI) duhet të aplikoj verifikimin e sigurisë për stafin e OE-së dhe të çfarëdo nënkontraktuesi, nëse një leje e tillë është e nevojshme për punët që do të

<sup>13</sup> Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Politikat e kontraktimit.

<sup>14</sup> Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm.

<sup>15</sup> Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Politikat e kontraktimit.

*kryhen sipas kësaj kontrate.<sup>16</sup> Auditori i Përgjithshëm ka qasje të pakufizuar në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit.<sup>17</sup>*

*Çdo institucion i Republikës së Kosovës është i detyruar që ta ketë njësinë e administrimit të dokumenteve. Çdo lëndë arkivore është e mbrojtur me ligj, pavarësisht nga koha, vendi dhe mënyra e krijimit, kush e posedon dhe ku gjendet, dhe duhet të ruhet në afat të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për lëndën arkivore. Lënda arkivore e vendosur në arkiv është e përvokueshme, e patjetërsueshme dhe nuk mund të asgjësohet e të keqpërdoret.<sup>18</sup>*

Dokumentet lidhur më projektin e e-edukimit janë zyrtare dhe duhet të kalojnë përmes njësisë për administrimin e dokumenteve. Mirëpo MASHTI nuk ka bërë administrimin e duhur të këtyre dokumenteve dhe nuk ka arritur të siguroj informacionin dhe të gjitha vendimet për grupet punuese, komisionet dhe koordinatorët e këtij projekti. Për më tepër ne kemi identifikuar se edhe gjatë periudhës së zhvillimit të projektit në disa nga raportet e komisioneve të pranimit është cekur se mungonin dokumentet bazë për vlerësim siç është kontrata dhe specifikat teknike që i nevojiteshin komisionit për të vlerësuar pranimin.

Përveç dokumenteve MASHTI ka mungesë të qasjes në sistemet dhe pajisjet ku janë të vendosura sistemet e zhvilluara nga ky projekt. Mungonte edhe dokumenti i protokolluar i dorëzimit të kredencialeve të qasjes në sisteme.

Lëndët arkivore të vendosura në arkiv janë të përvokueshme, të patjetërsueshme dhe nuk mund të asgjësohen. Mirëpo MASHTI nuk kishte një sqarim të duhur për mungesën e dokumentacionit të protokolluar në zyrën e arkivit të Ministrisë, duke u arsyetuar se gjatë kësaj periudhe ka ndodhur ndryshime të menaxhmentit dhe të stafit.

Prandaj, në mungesë të qasjes në sistem dhe të dokumentacionit të nevojshëm, MASHTI nuk ishte në gjendje të dëshmonte mbarëvajtjen e këtij procesi dhe të siguronte se produkti i këtij projekti do të mund të shërbente për qëllimin e zhvillimit e aq më pak tani që ka qëndruar pa u përdorur dhe mirëmbajtur. Po ashtu, gjatë këtij auditimi kemi informacionin e kufizuar për analizim dhe vlerësim.

#### ***4. MASHTI nuk ka menaxhuar dhe monitoruar mirë projektin për digjitalizimin e arsimit parauniversitar***

*Organizata duhet të analizoj, prioritarizoj dhe menaxhoj kërkesat për t'u siguruar se nevojat e përdoruesve janë plotësuar në mënyrë optimale dhe me kosto efektive.<sup>19</sup>*

*Organizata duhet të kryej testimet mbi sistemet TI-së dhe duhet të bazohet mbi rezultatet për pranimin ose refuzimin e sistemit.<sup>20</sup> Nëse Autoriteti Kontraktues (MASHTI) dëshiron të pretendojë se shërbimet e ofruara nga Ofruesi i Shërbimeve nuk kanë qenë në pajtim me kriteret e testit pranues, atëherë AK duhet të dërgoj njoftimin me shkrim për këtë te Ofruesi i Shërbimeve brenda 10 ditësh pune pas testit pranues (periudhës së afatit) dhe të deklarojë me shkrim arsyet përse Softueri nuk mund të pranohet në momentin e caktuar. Në rast*

<sup>16</sup> Kontrata për Modernizimin e sistemit të edukimit të Kosovës përmes e-Edukimit, nr. Reference :KOS 2012 - e-Edukimi, Instruksione për ofertuesit.

<sup>17</sup> Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Neni 25.

<sup>18</sup> Ligji Nr. 04/L-184 për Administrimin e punës në zyrë.

<sup>19</sup> Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Zhvillimin, Blerjen dhe Kontraktimin e jashtëm.

<sup>20</sup> Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Zhvillimin, Blerjen dhe Kontraktimin e jashtëm.



*se testi pranues nuk është kryer brenda 20 ditësh apo nëse AK nuk ka ngritur kurrfarë pretendimi deri në fund të periudhës së afatit, atëherë testi do të konsiderohet si i miratuar.<sup>21</sup>*

MASHTI nuk ka përgatitur një raport përfundimtar për realizimin e projektit. Pas çdo faze të projektit komisionet e pranimit kishin përgatitur raporte për realizimin e projektit. Raportet e komisioneve të pranimit nga ana e MASHTI-t ishin të mangëta dhe me pak informacion mbi ato që kanë pranuar në raport me specifikat teknike. Kemi raste që në raportet e pranimit është kërkuar që komisionit t'i ofrohen dokumentet bazë të projektit, kontrata me specifikat teknike për të cilat ishin thirrur të pranonin. Gjithashtu, në njërin raport të komisionit të pranimit nga MASHTI, kemi vërejtur se kanë kërkuar që OE të zbatoj obligimet (për të siguruar infrastrukturën përmes së cilës do të përdorej sistemi) të cilat në kontratë ishin përcaktuar si përgjegjësi të MASHTI-t. Për pranimin e fundit MASHTI ka kërkuar nga komisioni i pranimit që të raportoj pas realizimit të pagesës, megjithatë komisioni kishte vlerësuar se OE nuk ka realizuar punën sipas kërkesës dhe disa prej anëtarëve të komisionit edhe nuk kanë nënshkruar raportin. Për më tepër, komisionet e pranimit të MASHTI-t nuk kanë bërë teste dhe as raporte të testimit për pranimin e sistemit. Mirëpo, ata janë bazuar në testimet që ka prezantuar OE, disa prej të cilave i ka realizuar në prezencën MASHTI-t.

Prandaj, pa e testuar dhe pa pasur mundësi ta vënë në funksion sistemin, MASHTI nuk ka reaguar në periudhën e parapare në marrëveshje për aprovim apo mos aprovim të procesimit të pagesës dhe sipas kësaj pas kalimit të afatit heshtja konsiderohet aprovim.

Në këtë situatë të menaxhimit jo të mirë kanë ndikuar edhe paqartësitë e sjella nga MASHTI në menaxhimin e kontratës. Pasi që MASHTI nuk ka përcaktuar një zyrtar për menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratës, por MASHTI kishte përcaktuar në periudha të ndryshme të projektit koordinatorë dhe komisione pranimi për pjesë të ndryshme të kontratës. Ndërsa OE-ja kishte menaxherin e kontratës nga ana e tyre, si dhe kishte përgatitur raportet e punës, duke përfshirë edhe atë përfundimtar të cilat i kishte dorëzuar në MASHTI dhe tek kredi-dhënësi.

MASHTI nuk ka menaxhuar mirë as sigurimin e cilësisë për këtë projekt. Koordinatori për pjesën e e-Maturës ka kërkuar që të bëhet auditim për projektin që bazohej edhe në marrëveshjen e lidhur MASHTI me OE-në, por kjo nuk ishte bërë.

Si pasojë e menaxhimit të tillë ky projekt nuk është raportuar në Qeveri apo MF që ka përfunduar realizimi, mirëpo është raportuar i pa përfunduar, si dhe pagesa e fundit e procesuar në vlerë të 547,400 euro nuk është regjistruar në SIMFK.

Për shkak të menaxhimit të dobët, monitorimit jo adekuat gjatë realizimit dhe zhvillimit të këtij projekti, ky sistem nuk ka arritur qëllimin. Për më tepër sistemi është jashtë përdorimit dhe nuk ka arritur të shërbej për asnjë periudhë kohore, ashtu që të mundësoj digjitalizimin e arsimit, i cili ishte edhe qëllimi i zhvillimit të projektit.

##### **5. Zbatimi i marrëveshjes mes MASHTI-t dhe OE-së ka mangësi**

*Marrëveshja në nivel shërbimi është baza për monitorimin dhe kontrollin e kontraktorit ose furnitorit kundrejt specifikimeve teknike.<sup>22</sup> E drejta e autorit dhe e drejta e përdorimit: Klientit (MASHTI-it) do t'i jepet e drejta e autorit dhe të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale për Softuerin dhe kodin burimor përkatës, dokumentacionin, specifikimet dhe materialet e tjera që janë përgatitur dhe dorëzuar në përputhje me këtë Marrëveshje. Këto të drejta përfshijnë gjithashtu të drejtën për modifikim dhe caktim. E drejta e autorit është*

<sup>21</sup> Kontrata për Modernizimin e sistemit arsimor të Kosovës përmes e-Edukimit, KOS 2013 - e-Edukimi, Mars 2013.

<sup>22</sup> Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Politikat e kontraktimit.

*e kufizuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës dhe zyrat e saj lokale brenda territorit të Kosovës. Softueri nuk mund t'i shpërndalet asnjë pale tjetër jashtë Kosovës.<sup>23</sup>*

OE-ja pas përfundimit të modulit "e-Learning" ka dorëzuar në MASHTI kodin burimor për këtë pjesë, pastaj më vonë ai ka dorëzuar kodin burimor edhe për pjesën "e-Matura". Në marrëveshjen e MASHTI-t dhe OE-së është specifikuar që pas pranimit përfundimtar të projektit, OE-ja do të ofroj mirëmbajtje dy vjeçare. Dorëzimin e ka përfunduar OE-ja me zbatimin e projektit dhe për këtë ka përgatitur një raport përfundimtar. Mirëpo, MASHTI nga komisioni i pranimit për dorëzimin e fundit ka marr një raport të pa nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. Poashtu disa e-mail me vërejtjet për këtë pjesë i janë dërguar personit të autorizuar për aprovimin e projektit në MASHTI-t (ZKA/Sekretari i Përgjithshëm), mirëpo pagesa është realizuar për komplet projektin para se të përgatitej ky raport nga komisioni i pranimit, pasi që është përmbushur neni i marrëveshjes për aprovim në heshtje.

Ndërsa, sa i përket pjesës së mirëmbajtjes dy vjeçare, MASHTI nuk posedon ndonjë dokument apo raport të realizimit të mirëmbajtjes së produktit nga OE-ja. Për më tepër, MASHTI nuk ka vënë në përdorim sistemin që të realizojë qëllimin e zhvillimit të këtij projekti. MASHTI nuk ka qasje të administratorit në sistem dhe në infrastrukturën ku është vendosur sistemi dhe ka pohuar që këtë qasje e ka poseduar OE-ja deri në vitin 2020, ku dëshmohet përmes një komunikimi elektronik. Nga komunikimi vërehet që qasja nga OE-ja është dorëzuar në MASHTI përmes protokollit, mirëpo dokumentin e protokolluar të dorëzimit të qasjes që i referohen në shkresë, MASHTI nuk ka arritur ta sigurojë.

Pajisjet ku është i vendosur ky sistem gjenden në Qendrën e të Dhënave Shtetërore në ASHI, pa një qasje nga një administrator dhe çfarëdo qasje tjetër, me mungesë të mirëmbajtjes. Këta serverë kanë të ndezur sinjalizimin me drita, me ngjyrë që alarmon për dëmtimin e dy disqeve.

Në mungesë të një menaxheri nga ana e MASHTI-t që do e monitoronte zbatimin e kontratës në përpikëri, ka mangësi në pranimin e produktit në kohë dhe raportimin për përfundimin e projektit. Kjo ka ndikuar edhe në fillimin e kohës së mirëmbajtjes, e cila ka skaduar në vitin 2020. Gjithashtu, në mungesë të përcaktimit të përgjegjësive për këtë projekt ka mbetur sistemi pa administrim, pa qasje dhe ende vazhdon të qëndrojë pa u shfrytëzuar, si dhe nuk kanë njohuri nëse është ende funksional.

## **6. Kërkesat e sigurisë së informacionit në marrëveshjen e MASHTI-t dhe OE-së nuk janë adresuar**

*Kërkesat e sigurisë së organizatës duhet të jenë të theksuara nga kontraktori në mënyrë të përshtatshme.<sup>24</sup> Detyrimet e konfidencialitetit: Me kërkesë të Shitësit, Klienti (MASHTI) do të vendosë obligimin e konfidencialitetit për punonjësit e tij në lidhje me parimet dhe detajet e projektimit të Softuerit. Si dhe, për palët e tjera, të cilëve u jepet akses në Softuer. Softueri duhet të mbrohet nga çdo përdorim ilegal dhe i pa autorizuar.<sup>25</sup>*

MASHTI-it për modernizimin e sistemit të edukimit në Kosovë, nuk ka arritur të adresoj çështjet e sigurisë sipas kontratës lidhur me obligimin e konfidencialitetit për palët që kanë qasje në sistem.

Edhe pse ekziston neni në kontratë që përcakton mbrojtjen e informacionit të këtij projekti ne nuk identifikuar që MASHTI ka obliguar OE-në apo cilëndo palë me qasje në sistem të nënshkruaj deklaratat e konfidencialitetit. Për më tepër MASHTI i ka lejuar për periudhën kohore deri në vitin

<sup>23</sup> Kontrata për Modernizimin e sistemit të edukimit të Kosovës përmes e-Edukimit, nr. Reference :KOS 2012 - e-Edukimi, Instruksione për ofertuesit.

<sup>24</sup> Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Politikat e kontraktimit.

<sup>25</sup> Kontrata për Modernizimin e sistemit të edukimit të Kosovës përmes e-Edukimit, nr. Reference :KOS 2012 - e-Edukimi, Instruksione për ofertuesit.



2020 OE-së qasje të vetme me privilegje të administratorit dhe ende nuk e ka të definuar se kush e ka në posedim këtë qasje.

Arsyetimi nga zyrtarët e MASHTI-t për mungesën e deklaratave të konfidencialitetit ishte se kanë menduar që është e mjaftueshme marrëveshja e nënshkruar dhe se nuk kishte ndonjë të dhënë në sistem. Ndërsa mungesën e qasjes e kanë arsyetuar me mungesën e përcaktimit të personave përgjegjës për projektin dhe sistemin e zhvilluar. Megjithatë, këto arsyeime nuk janë të mjaftueshme dhe bien ndesh me kërkesat e kontratës ndërmjet MASHTI-t me OE-në, si dhe me standardet e sigurisë së informacionit.

MASHTI duke mos zbatuar standardet e sigurisë së informacionit ka rrezikuar komplet sistemin dhe ekzistimin e tij duke mos pasur asnjë lloj qasje në të.

## 4 Konkluzionet

MAShTI ka dështuar për të menaxhuar dhe zbatuar projektin e teknologjisë së informacionit “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit” për të përmbushur objektivat e këtij projekti dhe qëllimin e ministrisë për digjitalizimin e procesit mësimor dhe të testimit/vlerësimit të maturës. Ndërsa Qeveria e Kosovës për këtë projekt të pa funksionalizuar/shfrytëzuar ka obligime ndaj huamarrësit deri në vitin 2032, që do të paguhet nga Buxheti i Kosovës.

MAShTI ka mangësi në qeverisjen dhe operacionet e TI-së, pasi që nuk ka bërë identifikim të qartë të kërkesave dhe planifikimin e nevojave për zhvillimin e projektit e TI-së, për zhvillimin e sistemit dhe sigurimin e infrastrukturës harduerike. Prandaj nuk ka drejtuar dhe monitoruar efektivisht zbatimin e projekteve të TI-së në MAShTI, për përmbushjen e misionit të vet. Kjo ka ndikuar në dështimin e projektit për digjitalizim të arsimit parauniversitar në shkolla, në kosto totale prej 5,637,519 euro, duke dërguar në dëmtim të buxhetit për këtë shumë. Për këtë projekt do të paguhet deri në vitin 2032 në formë të kësteve të kredisë.

- Me informacionin e kufizuar që ka ofruar MAShTI ne nuk kemi arritur të vlerësojmë nëse Ministria ka menaxhuar zbatimin e marrëveshjes në nivel shërbimi-kontratë. MAShTI nuk ka arritur të ruaj dhe siguroj informacionin dhe të gjitha vendimet për grupet punuese, komisionet dhe koordinatorët e këtij projekti. Gjithashtu, nuk ka ofruar dokumentin e protokoluar të dorëzimit të kredencialeve të qasjes, si dhe ka mungesë të qasjes në sistemet dhe pajisjet ku janë të vendosura ato sisteme të zhvilluara nga ky projekt.

- MAShTI nuk ka menaxhuar mirë projektin, pa përcaktuar një menaxher për monitorimin dhe menaxhimin e projektit, nuk kanë arritur ta bëjnë pranimin përfundimtar të tij edhe përkundër realizimit të pagesave, ky projekt është raportuar i pa përfunduar. Gjithashtu, nuk ka siguruar cilësinë e produktit, duke u bazuar vetëm në atë që ka paraqitur OE, pa realizuar vetë testet e pranimit. Prandaj, sistemi i cili do të siguronte digjitalizimin e arsimit parauniversitar nuk është funksional.

- MAShTI nuk ka monitoruar mirë zbatimin e marrëveshjes, dhe nuk ka arritur të përgatis një raport përfundimtar për pranimin e projektit për të cilin ka paguar. Gjithashtu, nuk ka raporte që ka marr shërbimin e mirëmbajtjes të paraparë me kontratë pas pranimit të projektit. MAShTI nuk ka konsideruar kërkesat e sigurisë së informacionit për këtë projekt për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për më shumë nuk ka siguruar qasjen në sistem dhe pajisje ku është i vendosur, prandaj ka rrezikuar informacionin së bashku me ekzistencën e sistemit të zhvilluar. Edhe sot vazhdon të mos ketë qasje në këtë sistem që ka zhvilluar përmes projektit, që si pasojë nuk është në funksion dhe ka mbetur i pa shfrytëzueshëm.

## 5 Rekomandimet

Duke marrë parasysh kufizimet e paraqitura dhe që sistemi aktual është jofunksional dhe nevojën e mundshme për investime të ngjashme, këtu janë disa rekomandime për MASHTI për menaxhimin e projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit:

**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit duhet të sigurojë që:**

- 1. Planifikimin për projektet e TI-së, para se të inicioj dhe miratoj zhvillimin e çdo projekti të TI-së.** Të kryhet një studim i plotë fizibiliteti përpara se të fillohet me projektet e TI-së për të vlerësuar qëndrueshmërinë, kostot dhe përfitimet e mundshme. Ky studim duhet të përfshijë një analizë të gjendjes aktuale, kërkesave teknologjike, konsideratave buxhetore dhe rreziqeve të mundshme.
  - 1.1** Të bëj një analizë të gjendjes në terren për nevojat dhe shqyrtimin e rëndësisë së zhvillimit të projektit.
  - 1.2** Të hartoj planin e detajuar ideor, me analizën e kost benefitit, qëllimin e projektit dhe përfitimet që do të sjell ai projekt.
- 2. Sigurimin e infrastrukturës së nevojshme harduerike për zhvillimin e projektit,** në përshtatshmëri me kërkesat për zhvillimin e projektit kur ka të bëj me zhvillimin e platformave softuerike.
- 3. Dokumentacioni/informacioni dhe qasja në sistem.** Të ruaj vazhdimësinë e institucionit dhe të ruaj dokumentet e protokoluara për çdo projekt të realizuar dhe duhet të jetë në gatishmëri të i siguroj ato në çdo kohë.
  - 3.1** Të siguroj qasjen në sistemet që ka në pronësi dhe përgjegjësi dhe të sigurojë ruajtjen e qasjes sipas standardit për sigurinë e informacionit.
- 4. Menaxhimin e projektit.** Për të gjitha projektet që zhvillon, duhet të përcaktoj menaxherin e projektit për të mbikëqyrur realizimin e projektit.
  - 4.1** Menaxheri i projektit duhet të përcjell raportet e detajuara për punën e realizuar në projekt dhe gjithashtu duhet dorëzoj raportin përfundimtar për dorëzimin e projektit.
  - 4.2 Sigurimin e cilësisë në projekt.** Të siguroj cilësinë e produktit që pranon përmes zhvillimit të projektit, duke realizuar teste për ato që pranon.
  - 4.3** Kur është e paraparë me kontratë, (sikurse në marrëveshjen në fjalë për “e-Edukimin”) të siguroj edhe auditimin e cilësisë.
- 5. Sigurojë zbatimin e marrëveshjes mes MASHTI-t dhe OE-së,** për çdo marrëveshje/kontratë që lidh me palët tjera në përpikëri, duke përfshirë të gjitha obligimet që dalin nga ajo marrëveshje, përfshirë garancionin dhe mirëmbajtjen e sistemit.
  - 5.1** Të sigurojë qasjen në sistemin dhe serverët e projektit për modernizimin e sistemit të edukimit përmes e-Edukimit.
  - 5.2** Për çdo projekt që zhvillon duhet të përcaktoj personat përgjegjës në projekt për monitorimin dhe zbatimin e projektit.
- 6. Kërkesat e sigurisë së informacionit në marrëveshjen e MASHTI-t dhe OE-së.** Për çdo projekt që zhvillon të adresojë përmes marrëveshjes edhe çështjen e sigurisë së informacionit dhe ta zbatoj atë, si dhe duhet të ruaj konfidencialitetin.

Të zbatoj standardet e sigurisë së informacionit për ruajtjen e qasjes në sistemet që zhvillon.

## Shtojca I. Dizajni i auditimit

### Fushat me rrezik dhe motivi i auditimit

Realizimi i projektit të e-Edukimit për qëllimin e modernizimit të sistemit të arsimit në Kosovë, duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, është mundësuar përmes marrëveshjes për financimin e projektit duke bërë ratifikimin e kredisë eksportuese për një marrëveshje financiare mes Republikës së Kosovës si importues dhe Unicredit Bank Austria AG si eksportues.

Në auditimin e borxheve publike dhe garancitë shtetërore, auditorët kanë gjetur mangësi duke vërejtur një nënvlerësim të regjistrave kontabël për shumën prej 547,400€ në vitin 2017, në projektin e zhvilluar përmes huamarrjes për projektin e e-Edukimit, ku zbatues i projektit është MASHTI dhe kreditor UniCredit (me afat të realizimit dhjetor 2017) sipas marrëveshjes së kredisë nr.232.986 e datës 27 shkurt 2014. Në pagesën e fundit të shumës prej 547,400€, e cila është realizuar më datë 12 dhjetor 2017 nga Uni Credit Bank, auditorët nuk kanë gjetur dëshmi se kjo pagesë ishte regjistruar nga MASHTI në regjistrat kontabël në SIMFK (Sistemin e Informacionit për Menaxhimin e Financave të Kosovës). Edhe pse Thesari/Divizioni për Menaxhimin e Borxheve kishte njoftuar MASHTI-in më datën 12 dhjetor 2017 për të bërë regjistrimin e kësaj pagese në SIMFK, mirëpo kjo nuk ishte regjistruar.

Për projektin e e-Edukimit, MASHTI nuk kishte raportuar në Ministrinë e Financave, Divizionin e Borxheve, nëse kishte bërë pranimin teknik të këtij projekti. Megjithatë, auditorët kanë bërë një vizitë në terren për të ekzaminuar këtë projekt dhe sipas informacioneve të gjetura, ky projekt ende nuk është funksionalizuar, veçanërisht për programin e-Matura.

Në raportin e punës së komisionit pranues të datës 15 nëntor 2018, të cilin e kishte përgatitur një komision prej 5 anëtarësh për të vlerësuar produktet dhe efikasitetin e programit e-Matura, 2 anëtarë nuk e kishin nënshkruar raportin, duke konfirmuar se ky program ende nuk ishte funksionalizuar zyrtarisht.

Për të vazhduar analizën e obligimeve që rrjedhin nga kjo kontratë, MASHTI nuk i ka ofruar auditorëve dëshmi ose kopjen e marrëveshjes së blerjes nr. KOS-2013 e-Edukimi ndërmjet Bit Media e-Learning Solution GmbH & Co KG dhe MASHTI, të datës 19 mars 2013.

Duke parë rëndësinë e këtij projekti në sistemin e arsimit të vendit si dhe ndikimet financiare, ZKA ka vendosur të bëjë një auditim të veçantë të këtij projekti. Bazuar në kompleksitetin dhe nevojën për trajtimin e informacionit edhe për vitet e mëhershme (para 2017) është vendosur për auditim të performancës përkatësisht TI-së, pasi që ka të bëjë me zhvillimin e një sistemi të teknologjisë së informacionit, përkatësisht për trajtimin e problemit lidhur me funksionalizimin e këtij sistemi.

Gjithashtu, në raportin e progresit 2022 të Komisionit Evropian (KE) për Kosovën<sup>26</sup> është theksuar që: "Meqenëse rekomandimet e vitit të kaluar u zbatuan pjesërisht, në vitin e ardhshëm Kosova duhet në veçanti: → të zbatojë sistematikisht mekanizmat e sigurimit të cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit, veçanërisht në arsimin para universitar dhe atë profesional; Kosova ka përgatitur Strategjinë e re të Arsimit 2022 - 2027, e cila për herë të parë përfshin plane për digjitalizimin e shkollave. Strategjia është në pritje të miratimit zyrtar nga qeveria."

Siç e vërejmë edhe në raportin e progresit, që Kosova për herë të parë ka përfshirë planin për digjitalizimin e shkollave në Strategjinë e Arsimit 2022-2027, MASHTI kishte zhvilluar një projekt të

<sup>26</sup> Dokument Pune i Personelit të Komisionit Evropian - Raporti Për Kosovën \* 2022.

tillë vite më parë (2013-2017) pa e pasur të përfshirë në strategji apo plan, siç është “Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016”, mirëpo, kishte zhvilluar një projekt milionësh përmes huamarrjes pa një planifikim paraprak.

Ne gjatë fazës para-studimore, pasi që shqyrtuam kontratën e lidhur për këtë projekt dhe intervistat me zyrtarët përgjegjës të MASHTI-it identifikuam mangësitë në vijim:

- MASHTI nuk ka një analizë paraprake të gjendjes;
- MASHTI nuk ka një dokument planifikimi të projektit;
- MASHTI nuk ka siguruar infrastrukturën e nevojshme harduerike për përdorimin e një infrastrukture të tillë softuerike që ka zhvilluar;
- MASHTI nuk ka paraparë dhe zbatuar kërkesat e sigurisë së informacionit në raport me kontraktorin e jashtëm;
- MASHTI nuk ka siguruar një staf konsistent të monitoroj zhvillimin dhe zbatimin e projektit, me një mungesë të dukshme edhe në sigurimin e një menaxheri të projektit apo koordinatori, që do të monitoronte zbatimin e projektit nga fillimi deri në përfundim.

Si pasoj e këtyre mangësive projekti i zhvilluar nuk kishte hyrë në përdorim për zbatimin e digjitalizimit në shkolla. Prandaj, si përfundim realizimi i këtij projekti nuk ka arritur qëllimin e vet për digjitalizimin e shkollave në Kosovë.

Shqyrtimi i treguesve të problemit të identifikuar nga burime të ndryshme, takimet e mbajtura me personat përgjegjës për identifikimin e çështjeve në monitorimin e zhvillimit dhe zbatimit të projektit, si dhe nga vlerësimet tona të bazuara në Manualin Aktiv të Auditimit të TI-së<sup>27</sup> për identifikimin e fushave më me rrezik nga dokumentacioni i pranuar na orienton në problemin kryesor: MASHTI-i ka mangësi në qeverisjen e TI-së, ofrimin e mbështetjes efektive infrastrukture për arritjen e qëllimit të digjitalizimit, si dhe mangësi në procesin e planifikimit, blerjes, zhvillimit dhe kontraktimit të sistemeve të informacionit.

## Përshkrimi i sistemit

### Përgjegjësitë e institucioneve dhe dokumentet relevante

#### 1.1 Përgjegjësitë e institucioneve

##### 1.1.1 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

MASHTI përkrah një sistem arsimor jo diskriminues, ku respektohet e drejta e çdo personi për shkollim dhe ku mundësitë për mësim cilësor janë në dispozicion të të gjithëve. Ofron arsim joformal dhe arsim për të rriturit në të gjitha nivelet, duke përfshirë rajonet e largëta dhe përkrah mundësitë e shkollimit të përjetshëm për të gjithë. Përpilon, zbaton dhe mbikëqyrë format e drejta dhe efektive të administratës arsimore dhe të menaxhimit të shkollave. Përmirëson cilësinë, lidhjen dhe efikasitetin e arsimit në të gjitha nivelet. E ndihmon zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor dhe shpërndarjen e shërbimeve arsimore. Gjithashtu e përkrah hulumtimin lidhur me zhvillimin social, ekonomik, shkencor, teknologjik dhe kulturor të Kosovës. Ndërton një sistem gjithëpërfshirës bibliotekar, përkrah një politikë gjithëpërfshirëse për integrimin e personave me

<sup>27</sup> Manuali Aktiv i Auditimit- është platformë e zhvilluar nga ITWG/EUROSAT dhe WGITA/INTOSAI, që përdoret për identifikimin e fushave më me rrezik, përcaktimin e pyetjeve, kriterëve dhe metodologjisë së punës gjatë procesit të auditimit të TI-së.

aftësi të kufizuara. Përkrahë pjesëmarrjen e prindërve dhe të komunave në aktivitetet arsimore dhe në format përkatëse të bashkëpjesëmarrjes shkollë - komunitet në nivelin lokal dhe poashtu kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen Ministrisë më legjislacionin përkatës në fuqi.<sup>28</sup>

MASHTI në organizimin e rregullores së brendshme ka pesë departamente dhe katër divizione të veçanta, në kuadër të tyre bëjnë pjesë edhe departamentet në vijim:

- Departamenti i arsimit parauniversitar;
- Departamenti për integritime evropiane, koordinim të politikave dhe çështjeve ligjore; si dhe
- Departamenti i financave dhe shërbimeve të përgjithshme.




Figura 5. Organizimi i departamenteve të MASHTI-it të përfshira në fushëveprim

## Roli dhe përgjegjësitë e palëve

### Departamenti i arsimit parauniversitar

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të arsimit parauniversitar janë:

- Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve politike/ strategjike në fushën e arsimit parafillor, arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë dhe institucioneve tjera arsimore të nivelit parauniversitar në Kosovë në koordinim me Departamentin për integritime evropiane, mbështetjen ligjore dhe koordinimin e politikave;
- Në koordinim me Departamentin për integritime evropiane, mbështetjen ligjore dhe koordinimin e politikave, propozon, harton dhe siguron zbatimin e legjislacionit në institucionet arsimore në fushën e arsimit parashkollor, arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë dhe institucioneve të tjera arsimore të nivelit parauniversitar;
- Propozon, harton dhe siguron zbatimin e kurrikulave, pasuar nga ndryshimet korresponduese në metodologjinë e mësimdhënies, mësimin dhe vlerësimin të studentëve për arsimin parafillor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë;
- Ofron programe trajnimi për mësuesit në shërbim për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve arsimore të ofruara për shoqërinë;

<sup>28</sup>Rregullore Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive



- Përgatit organizimin e Testit të Arritshmërisë dhe Testit të Maturës;

Në kuadër të Departamentit të arsimit parauniversitar bëjnë pjesë:

- **Divizioni për arsim të përgjithshëm:** propozon, zhvillon dhe siguron zbatimin e projekteve për përmirësimin e cilësisë së arsimit në bashkëpunim me institucionet relevante.
- **Divizioni për kurrikula dhe mbështetje të mësimdhënësve:** propozon, harton, zhvillon dhe monitoron zbatimin e kurrikulave për arsimin parashkollor, arsimin fillor, ciklin e mesëm të ulët dhe ciklin e mesëm të lartë. Ofron mbështetje në zbatimin e kurrikulave dhe ofron mbështetje profesionale për tekstet shkollore dhe materialet didaktike.
- **Divizioni për sigurim të cilësisë, standarde, vlerësim dhe licencim:** përgatit dhe administron teste për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe analizon rezultatet e testimit. dhe
- **Divizioni për planifikim dhe standarde të infrastrukturës shkollore:** harton dhe siguron mbështetje për zbatimin e standardeve në lidhje me specifikimet e shkollave bazuar në standardet evropiane dhe merr pjesë në procesin e zhvillimit të kurrikulave duke siguruar informacion në lidhje me standardet e infrastrukturës shkollore dhe të pajisjeve.

### Departamenti për Integritim Evropian, Koordinim të Politikave dhe Çështjeve ligjore

Detyrat dhe përgjegjësitë e DIEKPÇL ka rolin qendror të koordinimit të politikave brenda ministrisë, duke siguruar koherencën dhe sinergjinë e të gjitha dokumenteve politike, strategjike dhe legjislative të lëshuara nga MASHTI. Në përmbushjen e rolit të saj, DIEKPÇL do të koordinojë tërthorazi me të gjitha departamentet dhe strukturat e tjera të MASHTI-it. Ofron mbështetje në koordinimin e aktiviteteve për procesin e integritimit evropian. Kontribuon dhe bashkëpunon me donatorët dhe partnerët zhvillimor të MASHTI-it. Ofron të dhëna/ informata për hartimin e raporteve javore, mujore, tremujore dhe vjetore. Harton planet mujore dhe vjetore të punës së MASHTI-it.

Në kuadër të këtij departamenti përfshihen Divizionet e mëposhtme:

- **Divizioni për integritim evropian:** Koordinon ndihmën e IPA-së dhe asistencën e huaj bilaterale dhe multilaterale të aktiviteteve të ministrisë dhe siguron që ajo të lidhet me prioritetet e ministrisë. Ofron mbështetje për strukturën organizative të ministrisë gjatë përgatitjes dhe menaxhimit të projektit;
- **Divizioni për koordinimin e politikave dhe monitorim të projekteve:** Kryen punë analitike për përgatitjen e projekteve dhe programeve sipas strategjisë së MASHTI-it. Kërkon donatorë të rinj dhe identifikon mundësitë e financimit. Koordinon dialogun me organizatat donatore për të identifikuar interesat e përbashkëta. Mirëmban bazën e të dhënave të donatorëve për të dokumentuar dhe monitoruar shkëmbimet dhe progresin me donatorët e mundshëm dhe donatorët e kaluar dhe aktual duke paraqitur mundësi të reja të mundshme për financim. Në bashkëpunim me Divizionin për mbështetje ligjore, hartim dhe koordinim të politikave, ndërton dhe mirëmban matricën e donatorëve duke siguruar mbulimin e të gjitha objektivave strategjike dhe zhvillon mekanizma për mbledhjen e informatave të duhura për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të projektit, aktiviteteve dhe rezultateve të projektit, si dhe miraton dhe jep komente për raportet mbi realizimin e projektit të hartuar nga Divizioni për zbatimin e projektit.;
- **Divizioni për zbatimin e projektit:** bën mbikëqyrjen, menaxhon dhe inspekton projekte të financuara nga MASHTI-i dhe burime të tjera financimi. Koordinon përcaktimin dhe formulimin e asistencës së nevojshme. Harton, zhvillon dhe miraton dokumentacionin e projektit dhe projektet e dizajnit të konceptit, në bashkëpunim me divizionet përkatëse të MASHTI-it. Koordinimi i përgjithshëm i aktiviteteve të projektit. Monitoron realizimin e projekteve në bashkëpunim me donatorët dhe kontraktorët dhe përgatit raportet e progresit dhe bashkëpunon me Divizionin për koordinim të donatorëve për të siguruar ndikimin maksimal të ndërhyrjeve si dhe kryeson takimet e bordeve drejtuese të projekteve.;

- **Divizioni për grumbullimin dhe analizën e të dhënave:** mirëmban dhe shfrytëzon sistemin informativ të menaxhimit të arsimit, duke lehtësuar qasjen e shpejtë në informata të besueshme relevante për sistemin arsimor, për të gjitha nivelet e arsimit. Mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore nga shkollat (të dhënat për studentët, stafin arsimor, të dhënat për arritjet dhe vijueshmërinë e nxënësve dhe gjendjen fizike të ndërtesave shkollore) për të gjitha nivelet e arsimit. Kryen analizën e të dhënave, interpretimin e të dhënave, kalkulon treguesit e arsimit dhe krahasimeve të tendencave për të siguruar dëshmi për përpunimin e politikave si dhe harton raporte relevante për të mbështetur procesin strategjik të vendimmarrjes, hartimin e dokumenteve të politikave dhe legjislacionin për të gjitha departamentet e MASHTI-it.

### **Departamenti i financave dhe shërbimeve të përgjithshme**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të financave dhe shërbimeve të përgjithshme janë si vijon: Koordinon përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit të ministrisë. Koordinon zbatimin në kohë të detyrimeve financiare të ministrisë. Mirëmban pajisjet e TI-së dhe ofron shërbime të TI-së. Kryen redaktimin, lekturimin dhe përkthimin e dokumenteve. Menaxhon sistemin e arkivimit dhe dokumentet e brendshme të ministrisë. Ofron shërbime logjistike për ministrinë.

Brenda Departamentit të financave dhe shërbimeve të përgjithshme përfshihen divizionet e mëposhtme:

-**Divizioni i buxhetit dhe financave:** përgatit propozimet buxhetore, të koordinon çështjet buxhetore për të gjitha strukturat administrative të ministrisë, të ndjek dhe raporton për ekzekutimin e buxhetit. Siguron që shpenzimet financiare të bëhen në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore. Menaxhon rezervat e mjeteve monetare dhe siguron që kontrolli i brendshëm financiar të bazohet në parimet e llogaridhënies dhe siguron bashkëpunim të ngushtë me auditorin e brendshëm dhe të jashtëm në përgatitjen e pasqyrave buxhetore dhe financiare të auditimit.

-**Divizioni i TI-së dhe shërbimeve logjistike:** siguron mbështetje në fushën e teknologjisë së informacionit. Mirëmban dhe administron sistemin e arkivimit të ministrisë dhe pranon palët e jashtme dhe i referon ato tek departamentet përkatëse.<sup>29</sup>

## Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi është MASHTI dhe departamentet përkatëse për menaxhimin e TI-së dhe projektit “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”.

Departamenti i arsimit parauniversitar; Departamenti për integritet evropiane dhe Departamenti i financave me divizionet përkatëse.

Fokus i auditimit është procesi i menaxhimit të projektit nga planifikimi deri në zbatim dhe monitorim për sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për digjitalizimin e arsimit në Kosovë përmes projektit “Modernizimi i sistemit të edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit”. Auditimi do të mbulojë periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2023.

## Pyetjet audituese

Për t’iu përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjet si në vijim:

1. *A drejton, vlerëson dhe monitoron efektivisht menaxhmenti i MASHTI-it përdorimin e TI-së në organizatë, me qëllim të përmbushjes së misionit të organizatës?*

<sup>29</sup> Rregullore (Qrk)-Nr.14/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



2. A është siguruar menaxhimi i shërbimeve të TI-së për plotësimin e kërkesave të përdoruesve të biznesit dhe a ndihmon në arritjen e objektivave të MASHTI-it?
3. Si i identifikon, prioritarizon dhe menaxhon MASHTI kërkesat për sistemet e TI-së?
4. Si e menaxhon dhe kontrollon zhvillimin ose blerjen e projekteve të aprovuara për TI-së MASHTI?
5. A siguron MASHTI se projektet TI-së arrijnë qëllimet e tyre nëpërmjet zhvillimit ose blerjes?
6. A e menaxhon kontraktorin ose furnitorin dhe ndërmerr veprimet e duhura MASHTI nëse performanca ose cilësia shmanget nga bazat e vendosura?
7. A ka zhvilluar MASHTI një marrëveshje të detajuar në nivel shërbimi së bashku me të gjitha kërkesat e projektit dhe a monitoron aktivisht Operatorin Ekonomik kundrejt marrëveshjes?
8. A janë adresuar në prokurim kërkesat e sigurisë së informacionit janë dhe a janë në përputhje me to?

## Kriteret e auditimit<sup>30</sup>

Kriteret e përdorura në këtë auditim rrjedhin nga Manuali Aktiv i Auditimit të TI-së<sup>31</sup>; Manuali i punës për Certifikimet e Auditimit në Sistemet e Informacionit të Shoqatës për Kontrollën dhe Auditimin e Sistemeve të Informacionit<sup>32</sup>; Kontrata për Modernizimin e sistemit të edukimit të Kosovës përmes e-Edukimit.<sup>33</sup>

**Për të vlerësuar menaxhimin e projekteve të MASHTI-it dhe funksionimin e sistemeve nga identifikimi i nevojave, planifikimi e deri te zbatimi i projekteve dhe monitorimi i projektit janë vendosur kriteret e mëposhtme:**

- Organizatat duhet të menaxhojnë projektet dhe investimet e tyre të TI-së, me qëllim maksimizimi të përfitimeve dhe konsiderimin e elementëve, të tillë si rrezikun, kapacitetet, dhe prioritarizimi në mes investimeve konkurruese.
- Arritja e matjeve të performancës duhet të jetë në përputhje me nevojat dhe qëllimet e biznesit.

Menaxhimi i kapaciteteve të TI-së duhet të bëhet sipas planifikimit dhe monitorimit të burimeve kompjuterike dhe të rrjetit për të siguruar që burimet e disponueshme të përdoren në mënyrë efikase dhe efektive. Kjo kërkon që zgjerimi ose reduktimi i burimeve të bëhet paralelisht me rritjen ose reduktimin e përgjithshëm të biznesit. Plani i kapaciteteve duhet të zhvillohet bazuar në të dhëna nga përdoruesit dhe menaxhmenti i Sistemeve të Informacionit për të siguruar që qëllimet e biznesit të arrihen në mënyrën më efikase dhe efektive. Ky plan duhet të rishikohet dhe përditësohet të paktën çdo vit.

Për realizimin e marrëveshjes për projektin e e-Edukimit: Klienti (MASHTI) është përgjegjës të siguroj përgatitjet e nevojshme për instalim që i bartë sipas instruksioneve të Operatorit Ekonomik dhe kërkesave teknike në shtojcën 1: Klienti duhet të bëjë parapërgatitjet e nevojshme teknike në mënyrë që OE të instaloj softuerin.

- Organizata duhet të analizoj, prioritarizoj dhe menaxhoj kërkesat për t'u siguruar se nevojat e përdoruesve janë plotësuar në mënyrë optimale dhe me kosto efektive.

<sup>30</sup> Për më shumë informata konsultoni ISSAI 300, Criteria, p.7

<sup>31</sup> Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është produkt i grupeve të punës së teknologjisë së informacionit të EUROSAT-t (WGITA) si dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI) për përcaktimin e rregullave e standardeve të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.- më tej Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

<sup>32</sup> ISACA - Manuali i Rishikuar Edicioni i 27të, i përditësuar për praktikatat e punës 2019, për Certifikimin e Auditorit të Sistemeve të Informacionit.

<sup>33</sup> Kontrata për Modernizimin e sistemit të edukimit të Kosovës përmes e-Edukimit, nr. Reference :KOS 2012 - e-Edukimi, Instruksione për ofertuesit.

- Organizata duhet të kryej testimet mbi sistemet TI-së dhe duhet të bazohet mbi rezultatet për pranimin ose refuzimin e sistemit.
- Organizata duhet të ketë dispozitat/parametrat e përcaktuar në Marrëveshjen në Nivel Shërbimi (kontratë) dhe veprimet për përcjelljen e tyre nga organizata.

Klienti (MASHTI) duhet të aplikoj verifikimin e sigurisë për stafin e OE-së dhe të çfarëdo nënkontraktuesi, nëse një leje e tillë është e nevojshme për punët që do të kryhen sipas kësaj kontrate.

- Marrëveshja në nivel shërbimi është baza për monitorimin dhe kontrollin e kontraktorit ose furnitorit kundrejt specifikimeve teknike.

E drejta e autorit dhe e drejta e përdorimit: Klientit (MASHTI-it) do t'i jepet e drejta e autorit dhe të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale për Softuerin dhe kodin burimor përkatës, dokumentacionin, specifikimet dhe materialet e tjera që janë përgatitur dhe dorëzuar në përputhje me këtë Marrëveshje, përveç nëse është rënë dakord ndryshe Shtojca 12. Këto të drejta përfshijnë gjithashtu të drejtën për modifikim dhe caktim. E drejta e autorit është e kufizuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës dhe zyrat e saj lokale brenda territorit të Kosovës. Softueri nuk mund t'i shpërndahet asnjë pale tjetër jashtë Kosovës.

Gjithashtu personat me qasje në informacion janë të obliguar të ruajnë konfidencialitetin lidhur me çështjet e përmendura më sipër edhe pas dorëheqjes së tyre nga pozita.

- Kërkesat e sigurisë së organizatës duhet të jenë të theksuara nga kontraktori në mënyrë të përshtatshme.

Detyrimet e konfidencialitetit: Me kërkesë të Shitësit, Klienti (MASHTI) do të vendosë obligimin e konfidencialitetit për punonjësit e tij në lidhje me parimet dhe detajet e projektimit të Softuerit. Si dhe, për palët e tjera, të cilëve u jepet akses në Softuer. Softueri duhet të mbrohet nga çdo përdorim ilegal dhe i pa autorizuar.

## Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit do të zbatohet metodologjinë në vijim:

- Rishikim i dokumenteve për tu siguruar që kërkesat e biznesit janë identifikuar dhe analizuar në përputhje me procesin e menaxhimit të kërkesave të organizatës.  
Rishikim i portfolios për të vlerësuar nëse projektet janë prioritarizuar në përputhje me kriteret e aprovuara.  
Rishikimi i kërkesave të aprovuara ose refuzuara për tu siguruar se ato janë në përputhje me parimet e pranuar të operimit.  
Intervistimi i menaxhmentit ose personave të tjerë përgjegjës për aprovimin e projekteve për tu siguruar se merren parasysh kapacitetet, aftësitë, burimet dhe trajnimi i stafit në organizatë, si dhe aftësia e përdoruesve për të shfrytëzuar mjetet, metodat dhe procedurat e reja.  
Intervistimi i menaxhimit për të përcaktuar procedurat e menaxhimit të investimeve të organizatës.
- Rishikimi i procesverbaleve të mbledhjeve në mes të palëve të interesit të biznesit dhe strukturës së TI-së;

Intervista me një mostër të përdoruesve të biznesit në nivele të ndryshme ose kryerja e sondazheve të plotësimit të kërkesave mbi cilësinë e shërbimeve nga grupi mbështetës i TI-së. Rishikimi i raporteve të TI-së për të verifikuar nëse janë parandaluar një sasi domethënëse e çështjeve kritike të shërbimeve të infrastrukturës harduerike dhe të rrjetit përpara se të raportohen nga përdoruesit e TI-së.

Kontrolli nëse parametrat e SLA-së rishikohen periodikisht nga menaxhmenti dhe nëse ekzaminohen çështjet e cilësisë së shërbimeve.

- Lista me kërkesat; Mostrimi i analizave të kërkesave; Kriteret për prioritarizimin e kërkesave. Rishikim i kërkesave të projektit për të përcaktuar se ato përmbajnë autorin, datën, prioritetin, koston, rrezikun dhe elementë të tjerë.

Rishikim i analizave të kërkesave ose të komenteve mbi to prej pronarëve të biznesit ose prej palëve të interesit, për të përcaktuar se të gjitha pikëpamjet janë përmbledhur për të kryer një analizë të plotë (pranim, diferencim, refuzim, etj).

Rishikim i kriterëve për prioritarizimin e kërkesave për të vlerësuar nëse ato përmbajnë elemente lidhur me koston, nevojat e biznesit, çështjet emergjente dhe kapacitetet e reja.

- Rishikim i planit të menaxhimit të projektit për t'u siguruar se ai përmban përshkrimin, qëllimin, koston, shtrirjen kohore, rreziqet, strukturën menaxheriale dhe identifikimin e palëve të interesit (të brendshëm ose të jashtëm) për projektin.

Rishikim i planit për tu siguruar se është i aprovuar nga menaxhmenti i lartë dhe përmban komente prej palëve të interesit.

Rishikim i strukturës organizative të projektit për të përcaktuar detyrat e individëve përgjegjës për sigurimin e cilësisë ose testimin, zhvillimin dhe instalimin e sistemit në infrastrukturën e TI-së, të organizatës, grupin mbështetës, etj.

Për projektet e furnizuara/të blera sigurohuni se plani liston se cilët do të jenë përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme dhe rishikoni çdo material të sjellë prej tyre për aprovim. Intervista me menaxherët e projektit për të përcaktuar cila metodë SDLC është duke u përdorur në zhvillimin e projektit.

- Rishikim i planeve të testimit. Krahasimi i kostove të projektit dhe programin me raportet e statusit të projektit për të vlerësuar shmangiet, nëse ka.

Intervista me menaxherët e projektit/ rishikim i raporteve për të përcaktuar nëse janë ndërmarrë veprimet e përshtatshme korrigjuese për shmangiet e mëdha.

Intervistim i grupit të menaxhimit të projektit dhe rishikim i procesverbaleve të mbledhjeve me kontraktorët për të vlerësuar frekuencën dhe efektivitetin e monitorimit të aktiviteteve të projektit të kontraktuar.

Rishikim i SLA-s ose kontratë tjetër për tu siguruar se janë duke u ndjekur kushtet e kontratës, për shembull shihni për rishikime periodike të kontraktorëve, dorëzimi i raporteve të statusit, përcjellja e planeve të veprimit, kryerja e aktiviteteve të menaxhimit në përputhje me kontratën.

- Rishikim të dokumenteve për të vlerësuar nëse është vendosur marrëveshja në nivel shërbimesh.

Rishikim të raporteve të monitorimit të dorëzuara nga kontraktori për tu siguruar se ato përmbajnë elementë që janë në kontratë ose në SLA (marrëveshja në nivel shërbimi), elementë si kosto, orari, performanca, rreziku, statusi, çështjet, dhe situata e veprimeve ose detyrave të mëparshme).

Rishikim të raporteve të monitorimit për të identifikuar mangësit e shërbimit/ devijimet si dhe vlerësim të ndikimit për shkak të këtyre mangësive /devijimeve.

Rishikimi i njoftimeve dhe raporteve të ndërmarra për veprimet e ndërmarra për të qenë në përpjesëtim me ndikimin në biznes dhe dispozitat kontraktuale.

- Rishikim të dokumentacionit për të vlerësuar se të gjitha kërkesat e përdoruesve janë përkthyer në kërkesat e nivelet e shërbimit.  
Rishikim të dokumentave për të vlerësuar se detyrat dhe përgjegjësitë e organizatës dhe të tregtarit janë identifikuar dhe janë implementuar.  
Rishikim të dokumenteve për të vlerësuar nëse parametrat për nivelet e performancës janë identifikuar qartësisht dhe nëse janë përfshirë në marrëveshjen në nivel shërbimi.

Rishikim të dokumenteve për të vlerësuar nëse mekanizmi i monitorimit të nivelit të shërbimit është vendosur dhe është aprovuar nga organizata dhe ofruesi i shërbimit.

## Dokumentet relevante

### Ligjet

#### **Ligji Nr. 04/L-32 Ligj për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës**

Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele

### Rregulloret

#### **Rregullore Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive**

Kjo rregullore përcakton fushat e përgjegjësisë dhe numrin e autoriteteve të larta të administratës shtetërore, si dhe fushat e përgjegjësisë dhe numrin e organeve të larta të administratës shtetërore.

#### **Rregullore (Qrk.)-Nr.14/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe organeve tjera të administratës shtetërore nën mbikëqyrjen e saj. Përfshihet nga paragrafi 1 i këtij neni, me këtë rregullore nuk përcaktohet organizimi i brendshëm i organeve të pavarura të administratës shtetërore nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe organeve tjera të administratës shtetërore nën mbikëqyrjen e saj, përcaktohen me shtojcën nr. 6 të Rregullores së Qeverisë nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

### Dokumente relevante

#### **Modernizimi i sistemit arsimor të Kosovës përmes “e-Edukimit”**

Dokumenti “Raporti Final i Raportit Fillestar” që është në përputhje me kontratën që ka MASHT me OE.

## Shtojca II: Letër Konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
22-03-2024			
Org. Jedinica Org. Unit	Org. Klasifikim Org. Code	Nr. Prot. Prot. No.	Nr. Fajqeve Str. Stranica No. Pages
06	47	314	1



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR			
Njesia Org. Org. Jedinica Org. Unit	018	Nr. Prot. Prot. No.	1029
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	1	Data Date	20.03.2024
Pristine / g			

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada-Government  
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije – Ministry of Education, Science, Technology and Innovation  
Kabineti i Ministrat/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

## LETËR KONFIRMIMI

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit për projektin 'Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit', dhe për zbatimin e rekomandimeve të përmbajtura aty.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: 20.03.2024

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit në lidhje me projektin *Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit* (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet në Raport, dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e tij;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzojmë një plan veprimi për implementimin e rekomandimeve të shtruar.

Me respekt,

Arbërie Nagavci  
Ministre, MASHTI







Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office



**Adresa:**

Zyra Kombëtare e Auditimit

Lagjja Arbëria

Rr. Ahmet Krasniqi, 210

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës